

VENDIM
Nr.80, datë 21.12.2007

**PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “ENPOWER ALBANIA” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E
IMPIANTIT PRODHUES (PARKU EOLIK NË KARABURUN, MALET KANALIT E
LLOGARA), SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 39 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 të “Rregullores për procedurat e licencimit” nenit 10, pika 1, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s” neni 18, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 “Rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 21.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (Parku Eolik në Karaburun, Malet Kanalit e Llogara), si burim i rinovueshëm energjie,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (Parku Eolik në Karaburun, Malet Kanalit e Llogara), si burim i rinovueshëm energjie.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta